

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			CAA
Nr. i prot.	2024/ZDP/302		
Br. prot./Prot.Nr.			
Faqe: 2	Kopja: /	Datë: 07.10/2024	
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date	
Hyrës/ulaznin.....	<input type="checkbox"/>		
Dalës/izlazno/out.....	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brendshëm/nterno/internal.....	<input type="checkbox"/>	Prishtinë/Prishtina/Pristina	

12/ZDP/VE/2024
Datë: 07.10.2024

Në mbështetje të nenit 15.1, nenit 21.2 dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 4 qershor 2008), të ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 30/2022, dt. 5 shtator 2022), në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 05/2015 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil, me ndryshime, Rregulloren (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror,

Duke ju referuar Vendimit nr. prot. 3187 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dt. 30.09.2024 dhe Rekomandimit të Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve me nr. prot 2024/DSF/299 të datës 03.10.2024, i plotësuar më dt. 07.10.2024,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr:

VENDIM

1. Autorizohet Dr. Luan Përçuku, i certifikuar nga AAC si Ekzaminues i Autorizuar Mjekësor (AME), të kryej në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë, ekzaminimet mjekësore për rivalidimin dhe ripërtirjen e certifikatave mjekësore të Klasit tre (3).
2. I Autorizuari nga pika 1 e këtij Vendimi, do shfrytëzojë hapësirat, procedurat, dokumentacionin e nevojshëm dhe pajisjet e duhura funksionale në hapësirat e QKMP Gjakovë, duke ruajtur parimin e konfidencialitetit mjekësor.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, ka pranuar Vendimin me nr. prot. 3187 (dt. 30.09.2024) të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, përmes të cilit është lejuar Dr. Luan Përçuku (AME) të kryejë ekzaminime mjekësore për personalin e aviacionit civil në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë (si njësi oraganizative e SHSKUK) dhe është obliguar Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë të ofroj mbështetje për qasje të plotë dhe të pakufizuar për AME-në, gjatë kryerjes së këtyre ekzaminimeve aero-mjekësore.

AAC në shkurt të vitit 2024 ka certifikuar Dr. Përçukun si Ekzaminues të Autorizuar Mjekësor, në bazë të kërkesave PART-MED të Rregullores (AAC) nr. 5/2015 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil, me ndryshime dhe Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

Gjatë auditimeve të realizuar nga AAC vitet e fundit në QKMP Gjakovë, AAC ka vlerësuar se kjo Qendër ka hapësira adekuate, procedura, dokumentacion dhe pajisje të duhura për kryerjen e ekzaminimeve aero-mjekësore, në përputhje me kërkesat legjislative.

Nga sa u tha me lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenet 15.1, 21.2 paragrafi 2 dhe 37 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, Rregulloren (AAC) nr. 05/2015 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil, me ndryshime, Rregulloren (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, Vendimin nr. prot. 3187 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSUK dhe Rekomandimit të Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve, ka vendosur si në diapozitiv të këtij Vendimi.


Burim Dinarama
UD Drejtor i Përgjithshëm



Prishtinë

Iu dërgohet:

- Dr. Luan Përçukut;
- Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë;
- Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve;
- Departamentit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Arkivit të AAC-së.